



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

Njoftim per konsultim publik

Këshilli i Bashkisë Korçë

Titulli: Mbledhja e rekomandimeve për projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

Propozuesi: Projektligji është depozituar nga një grup deputetësh dhe i është përcjellë Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Bashkisë Korçë për dhënie mendimi.

Sqarime për projekt aktin: Projektligji synon riorganizimin administrativo-territorial të njësive të qeverisjes vendore, duke parashikuar bashkinë si njësinë bazë të qeverisjes vendore, 46 bashki dhe 12 qarqe, si dhe organizimin e brendshëm sipas skemës Bashki - Qytet - Njësi Administrative. Për Bashkinë Korçë, konsultimi synon mbledhjen e mendimeve të banorëve mbi ndikimin e reformës në përfaqësim, identitet vendor, akses në shërbime publike dhe organizim territorial.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi publik do të realizohet në datat si më poshtë:

Nr.	Njësia Administrative	Data	Ora	Vendi
1	Nj.A. Voskop, Voskopojë, Leka	15.09.2026	17:00	Voskopojë
2	Nj.A. Mollaj, Vithkuq, Drenovë	16.09.2026	17:00	Njësia Mollaj
3	Nj.A. Bulgarec	17.09.2026	17:00	Tek oborri i shkollës
4.	Korca Qytet	18.09.2026	17:00	Tek Salla e Mbledhjeve te Keshillit

Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në linkun e mëposhtëm:

<https://bashkiakorçe.gov.al/2026/09/08/konsultim-per-projektligjin-per-reformen-administrativo-territoriale/>

Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak: Anëtarët e Këshillit Bashkiak, përfaqësues nga ekzekutivi, komisionet përkatëse të Këshillit të Bashkisë, Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik dhe administrata e Bashkisë Korçë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

- Nga komuniteti: Banorët e qytetit të Korçës dhe të njësive administrative, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet, biznesi, grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, grupet e marginalizuara dhe çdo qytetar i interesuar.

-Forma e konsultimit: Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	Mbledhja e mendimeve, komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve të komunitetit të Bashkisë Korçë për projektligjin për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.
Përshkrimi i çështjeve që trajton projektligji	Projektligji parashikon riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale në nivel vendor, duke përcaktuar 46 bashki dhe 12 qarqe. Ai ruan bashkinë si njësinë bazë të qeverisjes vendore dhe propozon organizimin e brendshëm sipas skemës Bashki - Qytet - Njësi Administrative, me synim forcimin e kapaciteteve administrative, përfaqësimin më të mirë të qyteteve përbërëse, ruajtjen e identitetit vendor dhe afrimin e koordinimit të shërbimeve me qytetarët. Konsultimi publik do të mbledhë mendimin e banorëve për ndikimin e propozimit në territorin e Bashkisë Korçë.
Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut	Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon: A jeni dakord me modelin e propozuar të organizimit Bashki - Qytet - Njësi Administrative? Si vlerësoni ndikimin e projektligjit në aksesin e banorëve në shërbimet publike vendore? A mendoni se propozimi ruan identitetin vendor dhe përfaqësimin e komuniteteve të Bashkisë Korçë? Cilat janë shqetësimet, sugjerimet ose alternativat tuaja për njësitë administrative dhe fshatrat që preken nga organizimi i propozuar? Tjetër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit të një përmbledhjeje të rekomandimeve dhe rezultateve të takimeve, që përfshin mendimet dhe propozimet e ardhura nga komuniteti; Dërgimin e përmbledhjes Kryetarit të Bashkisë, komisioneve përkatëse dhe çdo këshilltari të bashkisë; Shqyrtimin e rekomandimeve dhe të qëndrimeve të paraqitura nga publiku në mbledhjet/komisionet përkatëse; Përfshirjen e qëndrimit të Këshillit Bashkiak në mendimin zyrtar që do t'i përcillet institucioneve përgjegjëse; Informimin e komunitetit për marrjen në konsideratë ose mosmarrjen në konsideratë të rekomandimeve dhe arsyet përkatëse; Publikimin e informacionit për procesin në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit.
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Ndryshimet kryesore që trajtohen në projektligj lidhen me numrin dhe shtrirjen e njësive të qeverisjes vendore, organizimin e brendshëm të bashkisë, statusin e qyteteve përbërëse, përfaqësimin proporcional dhe mënyrën e koordinimit administrativ të shërbimeve në territor. Për Bashkinë Korçë, komentet e publikut mund të lidhen me njësitë administrative, fshatrat, aksesin në shërbime, përfaqësimin, ruajtjen e identitetit vendor dhe çdo alternativë tjetër të argumentuar.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve	Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 20 Shtator 2026, në adresën e email: eva.naci@bashkiakorce.gov.al
Data e publikimit	08.09.2026